

Forcimi i përpjekjeve për rikuperimin e aseteve në rajonin e OSBE-së

Lufta kundër krimit të organizuar transnacional dhe korrupsionit përmes shënjestrimit të të ardhurave të paligjshme të kriminelëve



Forcimi i përpjekjeve për rikuperimin e aseteve në rajonin e OSBE-së

Lufta kundër krimit të organizuar transnacional dhe korrupsionit përmes shënjestrimit të të ardhurave të paligjshme të kriminelëve

Ky projekt me financim të jashtëm synon të mbështesë shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së në gjurmimin, sekuestrimin, konfiskimin dhe ripërdorimin e aseteve të përftuara në mënyrë të paligjshme, në kuadrin e përpjekjeve të OSBE-së për të luftuar krimin e organizuar transnacional dhe korrupsionin. Projekti do të zgjasë gjatë 2022-2025 dhe do të zbatohet nga Departamenti i OSBE-së për Kërcënimet Transnacionale dhe Zyra e Koordinatorit të Aktiviteteve Ekonomike dhe Mjedisore të OSBE-së.

Situata

Krimi i organizuar transnacional dhe korrupsioni rrezikojnë zhvillimin socio-ekonomik, sigurinë e përgjithshme dhe sundimin e ligjit në zonën e OSBE-së dhe më gjerë. Në ndjekje të përfitimeve financiare, grupet e organizuara kriminale ushqehen nga korrupsioni me qëllim depërtimin dhe minimin e ekonomive legjitime dhe institucioneve shtetërore. Një mënyrë e provuar për të penguar dhe shkatërruar këto grupe është rikuperimi i aseteve. Procesi i gjurmimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të parave dhe pasurive të paligjshme i zhvesh nga pushteti grupet e krimit të organizuar dhe ndërpret ciklin e krimit dhe korrupsionit në mënyrë efektive.

Ky projekt bazohet në rezultatet e një projekti të mëparshëm me financim të jashtëm të OSBE-së me titull: "Forcimi i luftës kundër krimit të organizuar transnacional në Evropën Juglindore nëpërmjet përmirësimit të bashkëpunimit rajonal në sekuestrimin, konfiskimin, menaxhimin dhe ripërdorimin e aseteve". Ky projekt u zbatua nga viti

2019 deri në vitin 2023 nga Departamenti i OSBE-së për Kërcënimet Transnacionale dhe Zyra e Koordinatorit të Aktiviteteve Ekonomike dhe Mjedisore të OSBE-së. Projekti mbështeti Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë në përfundimin e përpjekjeve të tyre për rikuperimin e aseteve.

Projekti 2022-2025 mbështet këto shtete pjesëmarrëse në përpjekjet e tyre për rikuperimin e aseteve dhe zgjeron fushën e mbështetjes duke përfshirë Moldavinë dhe Ukrainën.

Përmbledhje e Projektit

Projekti trajton mangësitë dhe nevojat e shteteve pjesëmarrëse që do të përfitojnë në lidhje me ciklin e rikuperimit të aseteve. Këtu përfshihen:

- 1 Identifikimi, gjurmimi, sekuestrimi dhe konfiskimi i aseteve;
- 2 Menaxhimi i aseteve;
- 3 Ripërdorimi i aseteve.

Përfituesit:

Përfituesit kryesorë të projektit përfshijnë

punonjësit e institucioneve ligjzbatuese dhe gjyqësorit, siç janë përfaqësuesit e njëjësive përkatëse të policisë, gjyqtarët dhe prokurorët. Po ashtu, projekti punon me zyrat e menaxhimit të aseteve dhe organizatat e shoqërisë civile për të promovuar menaxhimin efektiv të aseteve të konfiskuara dhe ripërdorimin

e tyre për qëllime sociale, të tilla si dyqane, restorante dhe hapësira komunitare të ligjshme. Projekti vendos një theks të veçantë në nxitjen e përpjekjeve ndërkuftare nëpërmjet bashkëpunimit rajonal dhe shkëmbimit të praktikave të mira dhe mësimëve të nxjerra.

Rezultatet e pritshme:

1 Rritja e kapaciteteve të profesionistëve të drejtësisë penale për të identifikuar sistematikisht asetet kriminale dhe për të zbatuar masat e sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve, duke ofruar mbështetje për ndërtimin e kapaciteteve dhe politikave në lidhje me aspekte të veçanta të rikuperimit të aseteve, të përshtatura sipas nevojave të vendeve. Projekti do t'i kushtojë vëmendje të veçantë rritjes së kapaciteteve të gjyqtarëve.

2 Përmirësimi i shkëmbimit ndërkuftar informal të informacionit mbi rastet e krimit të organizuar duke ofruar mbështetje operacionale për të vetmin rrjet ekzistues informal të agjencive të menaxhimit të aseteve, Rrjetin e Agjencive të Menaxhimit të Aseteve në Ballkan dhe Konferencën e Përhershme të Prokurorëve të Krimit të Organizuar.

3 Promovimi dhe zbatimi i ripërdorimit për qëllime sociale të aseteve duke mbështetur projekte konkrete për ripërdorimin e aseteve të konfiskuara për qëllime sociale.

Partnerët:

Projekti zbatohet në bashkëpunim të ngushtë me misionet e OSBE-së, si dhe me subjekte qeveritare dhe jofitimprurëse në shtetet përfituese dhe në shtete të tjera pjesëmarrëse për të siguruar pronësinë dhe qëndrueshmërinë e rezultateve.

Donatorët:

Projekti mbështetet financiarisht nga Austria, Gjermania, Italia dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.



Kontributi në kuadër të OZHQ-ve:

Objektivi 16: Paqe, drejtësi dhe institucione të forta

